



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME**  
**Komiteti për Komunitete**  
Nr.01-060/01-21495/20 datë:26.10.2020



Npi – 01/252 datë: 30.10.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.10.2020, nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I M B L E D H J E S Ë -VIII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

E mbajtur më: 30.10.2020 (e premte) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, znj.Xhevahire Ramadani, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Zyrtar për Urbanizëm në DPUKGJ-ë z.Fatmir Rexhepi; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

**R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 30.09.2020,
2. Implementimi i projekteve të planifikuara në infrastrukturë në vendbanimet dhe lagjet ku jetojnë komunitetet gjatë vitit 2020 ( të ftohet për të informuar KPK-në Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Drejtori i DPUKGJ ).
3. Punësimi në Administratën Komunale, Shëndetësi dhe Arsim nga radhët e Komuniteteve ( të ftohet Zyra e personelit për informatë ).
4. Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.**

**\* Komiteti për Komunitete, unanimitet aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 30.09.2020

**Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.**

**\* Komiteti për Komunitete, unanimitet aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 30.09.2020.**

## Pika 2

### Implementimi i projekteve të planifikuara në infrastrukturë në vendbanimet dhe lagjet ku jetojnë komunitetet gjatë vitit 2020

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha z.Fatmir Rexhepit.

**z.Fatmir Rexhepi, Zyrtar i Urbanizmit;** Përshëndetje, unë jam sot këtu për arsye se Drejtoresha nuk është prezent dhe mua më ka autorizuar që të prezantoj këtë pikë në Komitetin për Komunitete. Sa i përket projekteve që kanë lidhje ose qasje Komuniteti pakicë janë disa prej tyre, po përmendim projektin me numër 49892 – asfaltimi i rrugës në fshatin Gjyrkovc. Ka edhe projekte tjera të shumta siq janë rregullimi i trotuareve, pastaj ndriqimit publik në Shtime. Për vitin e ardhshëm janë paraparë ndërtime të kanalizimit dhe rrugëve në brendi të fshatit Gjyrkovc. Unë i mirpres pyetjet e juaja nëse keni.

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Unë kam një pyetje për sa i përket projektit në fshatin Gjyrkovc, e para a ka me filluar projekti sivjet dhe e dyta pyetje a e ka fituar ndonjë operator tenderin për këtë projekt?

**z.Fatmir Rexhepi, Zyrtar i Urbanizmit;** Projektin për kanalizim dhe asfaltim të rrugës në Gjyrkovc për sivjet dhe vitin e ardhshëm e ka fituar operatori ekonomik “Kopshti”.

**z.Muhamet Ademaj;** Përshëndetje, e falënderoj Fatmirin për prezantimin e kësaj pike. Siq po shihet në Gjyrkovc projekti nuk paska përfunduar, po shpresojmë që vitin e ardhshëm të kryhet, dhe po ashtu po shpresojmë që edhe Komuniteti pakicë të ndahet i kënaqur.

**z.Arton Demiri;** Përshëndetje, te rruga “Anton Çeta” dua të pyes se a është e paraparë rregullimi i ndriqimit publik dhe trotuarit në këtë pjesë?

**z.Fatmir Rexhepi, Zyrtar i Urbanizmit;** (Sqaroj pyetjen por nuk është dëgjuar përgjigja).

**z.Ruzhdi Brahimi;** Përshëndetje, faleminderit për Informatën, por drejten me thënë po më habit fakti se si te projektet po përmendet vetëm fshati Gjyrkovc më shumë kur e dimë se qendra pra është Shtimja. Unë nuk jam kundër që të investohet edhe në fshatin Gjyrkovc, por siq e dini në Shtime ende ka shumë rrugica që nuk kanë infrastrukturë nuk kanë asfalt, trotuar e as ndriqim, po përmendi vetëm rrugicat që lidhen me rrugën “Enver Gashi” e njohur si rruga te mulliri i Tafës, ku në këtë rrugë vetëm dy rrugica janë të asfaltuara e shumica e rrugicave tjera nuk janë të asfaltuara.

**z.Fatmir Rexhepi, Zyrtar i Urbanizmit;** Mund të ju konfirmoj se te rruga “Nënë Tereza” ka me u bërë së shpejti ndriqimi publik.

**z.Muhamet Ademaj;** Në Buxhetin për vitin 2021, janë të parapara kategoria e projekteve kapitale dhe shumica e këtyre projekteve shkojnë për Shtimen, e pastaj edhe për fshatra. Buxheti ndahet me një gjithpërfshirje. Në Shtime pak rrugica kanë mbetur pa u asfaltuar.

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Unë kam bërë kërkesë gjatë miratimit të Buxhetit që të asfaltohen edhe rrugicat në Shtime, në Lagjet ku jetojnë komunitetet pakicë. Te Shefkia psh. Janë 10 shtëpi të cilat nuk bënë me i anashkaluar, pastaj e di që edhe te Ruzhdia ka disa shtëpi, por tani ne jemi duke pritë realizimin e këtyre projekteve.

**z.Fatmir Rexhepi, Zyrtar i Urbanizmit;** Mund të them se te rruga kah Mulliri i Tafës, siç u tha nga Ruzhdi Brahimi, janë të asfaltuara 6 rrugica e jo 2 siç u tha.

**z.Ruzhdi Brahimi;** Që të kuptohemi, unë e kam fjalën edhe për komunitetin shumicë e jo vetëm për komunitetin pakicë, për sa i përket realizimit të projekteve.

## Pika 3

### Punësimi në Administratën Komunale, Shëndetësi dhe Arsim nga radhët e Komuniteteve

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Meqnëse në mbledhje këtu nuk e kemi prezent ndonjë zyrtarë për prezantimin e kësaj pike, atëherë po kalojmë në pikën tjetër.

## Pika 4

### Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

**z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi informatën në pika kryesore.

Kthimi: Gjatë muajit shtator nuk ka pasur asnjë kërkesë për kthim.

Riatdhesimi: Gjatë muajit tetor nuk ka pasur asnjë të riatdhesuar.

Aktivitetet për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve RAE- 2018-2021  
Gjatë këtij muaji janë aktivizuar Qendrat Mësimore për mësim shtesë, BSFK-së në Shtime dhe ajo e WORAE –s në Gjyrkovc për t'i ndihmuar nxënës të komunitetit Ashkali dhe Rom.

ZKKK-ja me kohë ka kompletuar aplikacionet për bursa të nxënësve të shkollës së mesme dhe i ka dorëzuar në MA. Kompletimin e këtijë dokumentacioni e kanë bërë 21 nxënës dhe të njetin ZKKK e ka dorëzuar në MA, më 30.9.2020.

Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve: Në thirrjen publike për ndarjen e subvencioneve kanë aplikuar dy OJQ të komunitetit Ashkali, OJQ- KF”Blindona” – me projektin “Pajisje shkollore për nxënës të SHFML të komunitetit ashkali dhe rom në Komunën e Shtimes” dhe OJQ- “Art Stars Union”- me projektin “Të jetojm shëndetëshem”.

Pasi që janë zbatuar të gjitha procedurat paraprake, dy projektet të OJQ-ve, ZKKK-ja i ka proceduar me rekomandimin për aprovim, në Komisionin për Ndarjen e Subvencioneve.

Të dy projektet janë aprovuar, njëri 1000€ dhe tjetri 480€ për të cilat tani ka marrë vendim edhe kryetari i komunës.

Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesuara-aktivitetet e ndërgjegjësimit publik: Sa i përket programit të IOM-it, për projekte individuale dhe për projekte (2) për investime në infrastrukturë –kapitale, jemi në kontakt dhe kemi marrë shkresën nga IOM se komuna duhet të participojë me shumën 4280€ kurse IOM-i participon me shumën tjetër të dy projekteve të infrastrukturës-Ndriqim Publik në Gjyrkovc dhe Vojnovc ku shuma e përgjithshme është 18.280€. Projektet individuale janë në kontakt të drejtpërdrejtë me IOM-in dhe janë në zbatim e sipër

Çështje të tjera ose aktivitete: Jemi në pritje të sigurimit të pakove ushqimore përmes QPS-së ku do të përfitojnë familjet nga Lista e asistencës sociale por edhe familje të tjera që do t'i rekomandojë ZKKK.

Buxheti: ZKKK-ja gjatë këtij muaji, nga subvencionet ka shpenzuar 1480€, për projektet me thirrje publike.

Informatën e kemi të shkruar sikurse edhe informatat tjera që i kemi bërë, prandaj mund ta lexoni, i mirëpres pyetjet ose sugjerimet e juaja, (shih dokumentin).

## Pika 5

### Të ndryshme

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Fillimisht dua ta falënderoj OJQ-në “Loti i Jetimit” që i ka ndarë 500€ për udhëtim për studenten znj.Sabrie Veliun, sepse gjendjen ekonomiko-sociale të familjes e ka mjaft të vështirë. Po ashtu e falënderoj edhe z.Resul Makreshin, Zëvendës Ministër në Ministrinë e Shëndetësisë që na i ka dhuruar 2000 copë Maska për pandeminë KOVID19 komunitetit pakicë, në Komunën e Shtimes. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Muhamet Ademaj;** Në mbledhjen e fundit të Komitetit kemi formuar dy grupe për vizita nëpër shkolla. Ne si grup i parë i kemi vizituar të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Shtime, Gjyrkovc dhe Vojnovc. Unë dhe Diarta kemi hartuar një raport të shkurtër për këto vizita dhe ja kam dorëzuar sekretarisë. Gjatë vizitës që kemi bërë nuk kemi vërejtë ndonjë dallim që i bëhet nxënësve të komunitetit pakicë, kështu që edhe problemet edhe të mirat janë të përbashkëta. Kuptohet që në këtë kohë Pandemia KOVID19 është problemi më i madh për të gjithë, që ka të bëjë me mënyrën e organizimit të procesit mësimor.

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Dua ta potencoj rastin e një nxënësi Bejtulla Bajrushit i cili ka probleme sepse është i traumatizuar nga një aksident që ka pasur para 10 viteve. Kështu që ai tani po gëcë në mësim.

**z.Muhamet Ademaj;** Duhet me e gjetë një mënyrë për ti ndihmuar, qoftë me udhëzime se si mundet me e zgjidhë problemin lidhje me mësimin.

**z.Ruzhdi Brahimi;** Deshta me ta tërheqë vërejtjen kryesues, sepse asaj vajzës ato 500€ nuk ja paguan “Loti i Jetimit” por unë kam intervenuar para 6 muajve në Gjermani me kryetarin e PDAK-së për Gjermani.

**Kryesuesi, z.Rahman Kadrija;** Faleminderit, por informatën nuk e ke të saktë, sepse ktu i ka pranuar 500€ kryetari i shoqatës “Loti i Jetimit” z.Dalip Haliti. Kur ja ka dhënë paret më ka njoftuar edhe mua z.Dalip Haliti.

**z.Muhamet Ademaj;** Viti studentor asaj vajze i kushton 1000€, kështu që është mirë që me i ndihmuar disi me qëllim që të shkon deri në fund.

**znj.Diarta Vishesella;** Përshëndetje, në AAB nëse paguhet viti shkollor në fillim të vitit, ajo ka zbritje të madhe. Por normalisht që ka ndikim edhe nëse i ka notat e mira.

**z.Ruzhdi Brahimi;** Unë personalisht do të kujdesem që kjo vajzë mos të ngecë dhe ta përfundojë fakultetin me sukses. Për këtë premtim të gjithë anëtarët e Komitetit e falënderuan.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.15 h.

Procesmbajtës  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit  
Rahman Kadrija

